



©Robert Kneschke - stock.adobe.com

Albanisch

FËMIJA IM SHKON NË KOPSHT (KITA)

Këshilla për prindërit për kujdesinndaj fëmijëve

Ofrohet edhe në këto gjuhë:

Shqip

Arabisht

Anglisht

Persisht

Frëngjisht

Kurdishte kurmanxhi

Polonisht

Rumanisht

Rusisht

Turqisht

Ukrainisht

Përmbajtja

Parathënie	5
Kujdesi ndaj fëmijëve në Gjermani	6
Çfarë është qendra ditore për fëmijë?	7
Çfarë është kujdestari/kujdestarja e fëmijëve?	8
Kush ka të drejtë të përfitojë nga qendra ditore për fëmijë?	8
Sa kushton kujdesi në qendrën ditore për fëmijë?	9
Si është një ditë në qendrën ditore për fëmijë?	10
Çfarë është kopshti (KiTa)?	11
Pse duhet të shkojë fëmija im në një kopsht?	11
Sa kushton kujdesi në një kopsht?	12
Fillimi në kopsht – Familjarizimi	13
Kopshti – Rutina e përditshme	14
Çfarë i duhet fëmijës tim për kopshtin?	14
Këshilla për të kaluar bukur dhe pa stres në kopsht?	15
Informacione për prindërit – Organizimet e prindërve	15
Grupet shumëgjuhëshe prindër-fëmijë	16
Ndihma e hershme – Mbështetje dhe këshillim për familjet me fëmijë deri në 3 vjeç	17
Ekzaminimet e hershme – Një shans për çdo fëmijë	19
Portali KITA-ONLINE	20
Programi federal "Hyrja në kopsht: Ndërtimi i urave në arsimin e hershëm"	21
Literatura	22



Të dashur prindër,

Fillimi i kopshtit shoqërohet me shumë gjëra të reja për ju dhe fëmijën tuaj. Me siguri që ju si prind keni shumë pyetje në lidhje me këtë fazë të re zhvillimi:

- Kur është koha e duhur për kopsht?
- Si të gjej kopshtin apo qendrën e duhur ditore të kujdesit për fëmijë?
- Si funksionon familjarizimi?
- Çfarë i duhet fëmijës tim në kopsht?

Në mënyrë që të përgatiteni sa më mirë për fazën e re të jetës, ne po në këtë broshurë ju ofrojmë të gjitha informacionet e rëndësishme për kopshtin. Ajo ju ofron mbështetje dhe orientim se çfarë mund të presë fëmija juaj në qendrën e kujdesit ditor dhe në kujdesin ditor dhe çfarë lloj ndihme merr. Kolegët tanë janë të gatshëm t'u përgjigjen pyetjeve tuaja.

Ju uroj juve dhe fëmijës suaj shumë gëzime dhe gjitha të mirat për këtë periudhë.

Administratori juaj i qarkut

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Andreas Coenen', written in a cursive style.

Dr. Andreas Coenen

Kujdesi ndaj fëmijëve në Gjermani

Mundësitë e kujdesit ndaj fëmijëve deri në 6 vjeç

Qendra kujdesi ditor për fëmijë: Fëmijëve nën tre vjeç në veçanti u sigurohet kujdes në grupe të vogla në qendrën e kujdesit ditor nga persona të kualifikuar, të ashtuquajtur kujdestarë fëmijësh. Kjo mundëson mbështetje individuale. Shpesh kujdesi ofrohet në banesën e kujdestares ose kujdestarit apo në një qendër të madhe ditore për fëmijë.

Qendra ditore/kopshti i fëmijëve (shkurt KITA): Zakonisht në kopshte ofrohet kujdes dhe mbështetje për fëmijët nga dy deri në gjashtë vjeç. Misioni i kopshteve është edukimi, formimi dhe kujdesi. Kjo do të thotë se zhvillimi social, emocional, fizik dhe mendor i fëmijës promovohet në mënyrë të përgjithshme dhe individuale.




Figura 1: Paraqitje e thjeshtuar e opsioneve të kujdesit për fëmijët në Gjermani



VAKSINIMI - VAKSINIMI KUNDËR FRUTHIT!

Të gjithë fëmijët që marrin kujdes në kopshte, qendra ditore për fëmijë ose pranë një kujdestari kanë nevojë për dëshmi vaksinimi.



© Africa Studio – stock.adobe.com

Çfarë është qendra ditore për fëmijë?

- Qendra ditore për fëmijë është një propozim profesional për kujdes dhe edukim.
- Qendra ditore për fëmijë mund të ofrohet në këto vende: në banesën e kujdestarit, si pjesë e një qendre të madhe ditore për fëmijë ose në raste individuale, në banesën e prindërve.

Qendra ditore për fëmijë është:

- veçanërisht e përshtatshme për fëmijët e moshës 1-3 vjeç
- përkujdesje familjare dhe nënkupton një kujdestar të vetëm
- për grupe të vogla deri në pesë fëmijë
- kohë fleksibël përkujdesjeje: nga 15 deri në 45 orë
- përshtatje individuale e nevojave të fëmijëve
- arsimim dhe mbështetje e integruar e përditshme dhe persona të kualifikuar të kujdesit ditor.

Çfarë është kujdestari/kujdestarja e fëmijëve?

- Zakonisht një kujdestare ose kujdestar kujdeset maksimumi për pesë fëmijë në banesën e tyre ose në ambiente të marra posaçërisht me qira.
- Te një kujdestare ose kujdestar fëmijët mund të luajnë ose mësojnë. Ndërkohë që prindërit e tyre janë të zënë me gjëra të rëndësishme, kujdesi për ta është i sigurt.
- Kujdestarët e qendrave ditore për fëmijë kanë ndjekur kurse kualifikimi për t'u kujdesur për fëmijët. Ata pajisjen me një leje nga zyra përgjegjëse për fëmijët (Zyra e Rinisë) dhe verifikohen e kontrollohen rregullisht. Verifikohen edhe ambientet.

Kush ka të drejtë të përfitojë nga qendra ditore për fëmijë?

- Sipas nenit 24 të SGB VIII jepet e drejta për kujdesin ndaj fëmijëve pasi fëmija ka mbushur 1 vjeç.
- Në mënyrë që kjo e drejtë të zbatohet, është e domosdoshme që 6 muaj para fillimit të kujdesit duhet paraqitur një kërkesë për përkujdesje pranë Zyrës së Rinisë.
- Nëpërmjet këshillimit të specializuar realizohet sistemimi në qendrën ditore për fëmijë. Për këtë qëllim përdorni portalin e regjistrimit "Kita-Online" sipas qytetit ose komunës përkatëse në qarkun Viarsen.
- Të gjithë fëmijët në Gjermani kanë të drejtën e formimit, edukimit dhe përkujdesjes dhe mund të ndjekin një qendër kujdesi ditor ose kopsht, edhe kur prindërit nuk shkojnë në punë.

Gjetja e një vendi përkujdesjeje

Mundësia 1

- Thjesht drejtojuni Zyrës përgjegjëse të Rinisë. Kjo është Zyra e Rinisë e komunës ku po qëndroni për momentin. Të dhënat e kontaktit të Zyrës përkatëse të Rinisë në qarkun Viersen i gjeni në internet.

Mundësia 2

- Informohuni për vendet e përkujdesjes në qendrën ditore të fëmijëve në rrethinën tuaj dhe regjistroni nevojën tuaj për një vend në portalin KITA-ONLINE në qarkun Viersen.

Mundësia 3

- Kontaktoni me një qendër ditore për fëmijë. Mund të kërkonit një kujdestar të përshtatshëm që ofron përkujdesje ditore në nivel lokal. Kur të keni gjetur një kujdestar, mund të pyesni direkt në vend për një vend të lirë. Më pas kujdestari do t'ju tregojë nëse mund ta marrin fëmijën tuaj dhe çfarë dokumentesh dhe informacionesh ju nevojiten.

Sa kushton kujdesi në qendrën ditore për fëmijë?

- Tarifa për kostot duhet t'i paguhet Zyrës së Rinisë për përdorimin e qendrës ditore për fëmijët. Shuma e tarifës varet nga të ardhurat tuaja bruto dhe orët e kujdesit për të cilin është rënë dakord.



Informacionet mbi kujdestarët në rrethinën tuaj i gjeni në faqen e internetit: www.familienwegweiser-kreisviersen.de.

Si është një ditë në qendrën ditore për fëmijë?

- Në mëngjes prindërit sjellin fëmijët në qendrën ditore. Pastaj përgjithësisht hahet mëngjes bashkërisht. Më pas kujdestari apo kujdestarja luan dhe këndon me fëmijët. Ata i ndihmojnë fëmijët me zhvillimin e të folurit, i nxitin të mësojnë dhe i shoqërojnë jashtë. Aty fëmijët mësojnë gjëra të rëndësishme, si p.sh. rregullat e qarkullimit rrugor dhe vështrojnë natyrën dhe mjedisin. Ata i zhvillojnë aftësitë e tyre duke luajtur në shtëpi.
- Në qendrën ditore ata ushqehen dhe flenë në drekë. Kujdestarja apo kujdestari u ndërrojnë edhe pelenat. Gjithashtu i jepet rëndësi faktit që fëmijët të kujdesen në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurt.



Figura 1: Paraqitje e thjeshtuar e opsioneve të kujdesit për fëmijët në Gjermani



© Sergey Novikov - stock.adobe.com

Çfarë është kopshti (KiTa)?

- Zakonisht në kopsht ofrohet kujdes dhe mbështetje për fëmijët nga dy dhe gjashtë vjeç.
- Të gjithë fëmijët nga mosha tre vjeç derisa të hyjnë në shkollë kanë të drejtën e një vendi në kopsht.
- Zakonisht viti i përkujdesjes fillon në gusht.

Mundësitë e kujdesit ndaj fëmijëve deri në 6 vjeç

- Kopshti është një vend i sigurt. Këtu fëmija juaj gjen shoqëri.
- Fëmija juaj mëson gjermanisht dhe përgatitet mirë për shkollë.
- Gjatë kohës që fëmija juaj është në kujdes, ju si prindër, keni p.sh. kohë të mësoni vetë, të shkoni të punoni ose të kujdeseni për familjen.
- Në kopsht njiheni me prindër dhe fëmijë të tjerë. Secili është i mirëpritur. Nëse keni ndonjë kërkesë apo shqetësim, flisni me edukatorët.

Gjetja e një vendi në kopsht

Mundësia 1

- Kërkesën për një vend mund ta paraqitni në portalet e ndryshme Kita-Online të Zyrës së Rinisë të qarkut Viersen. Përdorni gjithmonë portalin Kita-Online të vendbanimit tuaj. Të dhënat e kontaktit të Zyrës përkatëse të Rinisë Qarkun Viersen e gjeni në këtë broshurë në faqen 24.

Mundësia 2

- Kontaktoni direkt me një kopsht. Mund të kërkonti një kopsht të përshtatshëm në vendbanimin tuaj. Kur të keni gjetur një kopsht, mund të pyesni direkt aty për një vend të lirë.
- Kur kopshti t'ju ofrojë një vend të lirë, atëherë fillojnë procedurat e regjistrimit. Për këtë do të bisedoni me kopshtin për pranimin e fëmijës. Pastaj kur të keni vendosur për kopshtin, do të nënshkruani një kontratë me të.

Sa kushton kujdesi në një kopsht?

- Kostot për kopshtin dhe ushqimin ndryshojnë. Shuma e tarifës që jepet nga prindërit varet nga shuma e të ardhurave tuaja bruto dhe numri i orëve të kujdesit për të cilin keni rënë dakord. Nëse deri më 30 shtator fëmija juaj mbush 4 vjeç, nuk duhet të paguani më asnjë kontribut derisa të fillojë shkollën. Tarifa e ushqimit ndryshon dhe duhet të pyesni në kopsht.

Kur hapet dhe kur mbyllet kopshti?

- Kohët e kujdesit varen nga kopshti përkatës dhe oferta për një vend të lirë. Ka vende të lira në kopsht me këto orare javore: 25 orë kujdes, 35 orë kujdes ose 45 orë kujdes.



© akira_photo - stock.adobe.com

Fillimi në kopsht - Familjarizimi

- Fillimi në kopsht quhet familjarizim. Familjarizimi është diçka interesante dhe e re. Për prindërit dhe fëmijën. Kopshti ju ndihmon.
- Fëmija juaj duhet të përshtatet mirë në kopsht. Fillimisht së bashku me ju. Dhe pastaj vetëm.
- Në fillim do të qëndroni me fëmijën tuaj në kopsht. Vizitat e para janë më të shkurta. Kohët i vendosni çdo ditë me edukatoret. Në këtë mënyrë ju dhe fëmija juaj mësoheni mirë me ambientin. Dhe krijoni besim tek edukatoret.
- Familjarizimi në kopsht mund të zgjasë shumë javë.

i

GJËRAT QË DUHET TË DINI:

- Duhet të jeni gjithmonë i arritshëm në telefon.
- Qarja është shumë normale. Edukatoret e marrin fëmijën me të mirë.
- Ju i jepni kopshtit informacionet e rëndësishme për fëmijën sip. sh. për alergjitë, sëmundjet kronike ose nevoja të tjera të veçanta.

Kopshti - Rutina e përditshme



Figura 1: Paraqitje e thjeshtuar e opsioneve të kujdesit për fëmijët në Gjermani

Çfarë i duhet fëmijës tim për kopshtin?

Lista e plotë e shembujve

- ✓ Çanta e shpinës / Çanta
- ✓ Kutia e ushqimit
- ✓ Shishja e ujit
- ✓ Pantoflat
- ✓ Veshjet sipas stinës: kapele kundër diellit, rroba banje, kapuç, shall, dorashka
- ✓ Veshje kundër shiut: kominoshe, xhup shiu, çizme
- ✓ Ndërresa
- ✓ Pelena dhe letra të lagura sipas nevojës
- ✓ Një foto të fëmijës suaj
- ✓ Ngjithëse emri

Këshilla për të kaluar bukur dhe pa stres në kopsht?

- Bëni gati sa më shumë prej tyre një natë përpara që në mëngjes ta keni shumë më të lehtë.
- Jini të përpiktë me orarin e kopshtit që të keni kohën e mjaftueshme për t'u përshëndetur me fëmijën pa u nxituar.
- Nëse jeni me vonesë, merreni kopshtin në telefon!
- Zbatoni oraret e marrjes, fëmija juaj mezi ju pret!
- Jini të përgjegjshëm ndaj marrëveshjeve të rëna dakord.
- Pyesni nëse nuk e kuptoni diçka.
- Jini miqësor, të sinqertë dhe bisedoni me specialistët – kjo çon në bashkëpunim të suksesshëm.

Informacione për prindërit – Organizimet e prindërve

- Shumë institucione përdorin letra për prindërit, afishime dhe organizime për informim ose aplikacionin KiTa-App si mënyra komunikimi për të informuar prindërit mbi të rejat në kopsht. Bëni kujdes kur ecni në ambientet e kopshtit të fëmijës suaj dhe kontrolloni rregullisht njoftimet dhe raftin e fëmijës suaj që të mos ju shpëtojë gjë.
- Në mbledhjet e prindërve, zakonisht jepet informacion mbi punën edukative, ndryshimet e personelit ose rutinat e përditshme.
- Shfrytëzoni këtë mundësi për të bërë pyetje si dhe njihuni me prindërit e tjerë.

Grupet shumëgjuhëshe prindër-fëmijë

Griffbereit

Familien entdecken gemeinsam
Spiel und Sprache



- Program edukimi familjar për prindërit dhe fëmijët e tyre nga 0 deri në 3 vjeç.
- Promovimi i shumëgjuhësisë përmes aktiviteteve për fëmijë.

Rucksack KiTa

Alltagsintegrierte Sprach- und Familienbildung



- Program edukimi familjar për prindërit dhe fëmijët e tyre nga 4 deri në 6 vjeç, që shkojnë në kopsht.
- Promovimi paralel i gjuhës së familjes dhe gjuhës përreth.



Për më shumë informacion, kontaktoni
Qendrën Komunale të Integritit të qarkut Viersen
në nr. e telefonit: 02162 39-1961
ose në adresën e emailit: felicia.bot-jurca@kreis-viersen.de

Ndihma e hershme - Mbështetje dhe këshillim për familjet me fëmijë deri në 3 vjeç

Pjesa më e madhe e **prindërve gëzohen shumë** kur bëhen me fëmijë. Fëmija mund të **sjellë shumë** gëzim. Ardhja e fëmijës në jetë **ndryshon shumë gjëra**. Ndaj, prindërit duhet të mësojnë **plot gjëra** të reja. Dhe shumë **gjëra duhet t'i bëjnë ndryshe** nga më parë.

Ndihmat e hershme mund të jenë:

■ Këshillimi

Këshillimi mund të jepet në telefon ose personalisht.

■ Ndërmjetësimi

Me anën e ndërmjetësimit prindërit marrin ndihmë. Për shembull, me anën e mamisë së familjes, infermieres së familjes ose përmes klinikës së pediatrit.

■ Shoqërimi

Shoqërimi nënkupton: Kur dikush kujdeset për familjen. Për shembull, kur mamia e familjes ju vjen në shtëpi.

Ndihmat e hershme asistojnë:

- Me shtatzëninë.
- Kur nënat dhe baballarët duhet të kujdesen për foshnjat.
- Nënat dhe baballarët me fëmijë të vegjël deri në moshën 3-vjeçare.



- Të gjitha ofertat për ndihmë të hershme janë pa pagesë: Udhërrëfyesi familjar në qarkun Viersen: www.kreis-viersen.de/themen/soziales/auf-familienwegweiser
- Ofertat janë **vullnetare**.
- Gjithmonë keni të drejtën të vendosni nëse doni të merrni pjesë në një ofertë ose jo.

Të dhënat e kontaktit për ndihmën e hershme

Ndihma e hershme për qytetin Kempen

Zyra e Çështjeve Familjare + Zyra e Koordinimit për Ndihmën e Hershme "iM DiALOG"

- Sandra Müller
Telefon: 02152 9173037
Email: sandra.mueller@kempen.de

Ndihma e hershme për qarkun Viersen

Qarku Viersen - Zyra për Shkollat, Rininë dhe Familjen:
Brüggen, Grefrath, Niederkrüchten, Schwalmtal. Tönisvorst

- Nina Becker
Telefon: 02162 39-1869
Email: nina.becker@kreis-viersen.de

Ndihma e hershme për qytetin Nettetal

Zyra e Çështjeve Familjare dhe Koordinimi i Ndihmës së Hershme + Këshillim i Specializuar për Qendrat Ditore

- Inga Hinz
Telefon: 02153 898-5303
Email: inga.hinz@nettetal.de

Ndihma e hershme për qytetin Viersen


Koordinimi i Rrjetit KONKRET – Përkrahja për familjet dhe nënat e reja

- Nicole Henneböhl
Telefon: 02162 101-768
Email: nicole.henneboehl@viersen.de

Shanset e hershme për qytetin Willich

Rrjeti i Koordinimit të Shanseve të Hershme për qytetin Willich

- Melanie Genz
Telefon: 02154 48-1508
Email: m.genz@caritas-viersen.de



© fizkes - stock.adobe.com

Ekzaminimet e hershme - Një shans për çdo fëmijë

- Ekzaminimet e hershme i ofrojnë fëmijës suaj mundësinë që që çrregullimet e mundshme shëndetësore ose anomalitë në zhvillim të mund të njihen dhe trajtohen në një fazë të hershme dhe që fëmijës suaj, nëse është e nevojshme, t'i jepet mbështetje dhe inkurajim i veçantë.
- Në çdo ekzaminim, duhet të merrni me vete fletoren e verdhë të ekzaminimeve të fëmijës, kartën e siguracionit ("Karta e shëndetit") dhe kartën e vaksinimit.
- Takimet për kontrollet individuale i caktoni me klinikën mjekësore ku zgjidhni të çoni fëmijën tuaj.
- Prandaj, për siguri caktojini takimet me klinikën në kohë dhe mos humbisni asnjë ekzaminim të hershëm.

- Në portalin KITA-ONLINE prindërit mund të paraqesin kërkesën e tyre për një vend të lirë si në kopsht, ashtu edhe në qendrën ditore.
- Regjistrimi i kërkesës nëpërmjet KITA-ONLINE nuk zëvendëson një vizitë personale të vetë prindërve në kopshtin e dëshiruar ose të kujdestarëve sipas zgjedhjes së tyre. Vendet e lira për fëmijët ndahen nga kopshtet dhe kujdestarët vetëm nëse paraprakisht ka pasur kontakt personal, p.sh. në formën e një bisede personale, një vizite në institucion ose një vizite në "Ditën e Dyerve të Hapura". Mbani parasysh se regjistrimi i kërkesës përmes KITA-ONLINE nuk garanton asnjë vend në institucionin tuaj të dëshiruar.
- Në portal gjeni të gjitha institucionet e kujdesit për qytetin ose komunën përkatëse. Për përdorimin duhet të regjistroheni në Portal dhe të krijoni një llogari përdoruesi.

Nëse keni pyetje mbi KITA-ONLINE, ju lutemi të kontaktoni:

Brüggen, Grefrath, Niederkrüchten, Schwalmthal dhe Tönisvorst

- Inga Dockhorn
Telefon: 02162 39-1677
Email: kita-online@kreis-viersen.de

Qyteti Kempen

- Katharina Terhoeven Christina Klingenberg
Telefon: 02152 917-3064 02152 917-3062
Email: kitaonline@kempen.de

Qyteti Nettetal

- Inga Hinz Stefan Reinders
Telefon: 02153 898-5103 02153 898-5103
Email: inga.hinz@nettetal.de dhe stefan.reinders@nettetal.de

Qyteti Viersen

- Email: kitaonline@viersen.de

Qyteti Willich

- Kinga Lukasik
Telefon: 02154 949-646
Email: kinga.lukasik@stadt-willich.de

Programi federal "Hyrja në kopsht: Ndërtimi i urave në arsimin e hershëm"

Programi promovon oferta me prag të ulët për familjet refugjate ose që kanë vështirësi të veçanta aksesit që përgatitin dhe mbështesin hyrjen në qendrën ditore të kujdesit.

Koordinimi për qarkun Viersen

Zyra për Shkollat, Rininë dhe Familjen:

Brüggen, Grefrath, Niederkrüchten, Schwalmtal, Tönisvorst

- Georgina Smith
Telefon: 02162 39-1844
Email: georgina.smith@kreis-viersen.de

Koordinimi për qytetin Nettetal

- Anke Heraiech
Telefon: 02153 898-5133
Email: anke.heraiech@nettetal.de



Literatura

Më poshtë gjeni literaturën, të cilës iu kemi referuar në këtë udhëzues.

Boller, Anne. (2008). Fëmija im shkon në kopsht, Mynih (Botimi 1.): Ernst Reinhardt GmbH& Co KG Verlag

Ekipi i Formimit të Hershëm, Kujdesit dhe Edukimit (FBBE), Zyra e Shtypit Paritatische Hamburg (2017). Mirë se vini në kopshtin tonë, Berlin: Der Paritatische Gesamtverband

Diehl, Ute dhe Karl (2007). Udhëzuesi i prindërve për kopshtin, parashkollorin dhe shkollën fillore, këshilla dhe ndihmë për jetën e përditshme shkollore, Osna-brück

Engelsmann, P., ElternLeben.de (2019). Fëmija im shkon në kopsht, për një fillim të mbarë në kopsht, Hamburg: tredition GmbH

Ministria e Kulturës e Saksonisë së Poshtme (2020). Fëmija im në kujdesin ditor, informacione për prindërit mbi institucionet e kujdesit ditor dhe kujdestarëve për fëmijët në Saksoninë e Poshtme, Hanover: oeding print GmbH

Falënderime të përzemërta për bashkëpunimin në krijimin e kësaj broshure shkojnë për:

Zyrën për Shkollat, Rininë dhe Familjen e Qarkut Viersen

Këshillimi i Specializuar i Kujdesit Ditor për Fëmijët

Znj. Susanne Reinartz

Znj. Katja Schulte

Ndihma e hershme

Znj. Nina Becker

Programi federal "Hyrja në kopsht: Ndërtimi i urave në arsimin e hershëm"

Znj. Georgina Smith

Znj. Sabrina Beyen

Znj. Sylvia Fretz

KiTa-Online

Znj. Inga Dockhorn

Qarku Viersen

Zyra për Mirëqenie Sociale – Qendra Komunale për Integrim

Rathausmarkt 3 | 41747 Viersen

www.kreis-viersen.de

Financuar nga:

**Ministerium für Kinder, Jugend, Familie,
Gleichstellung, Flucht und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen**



**Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen**



Impressum

Botuesi: Qarku Viersen – Administratori i qarkut
Zyra për Mirëqenie Sociale – Qendra Komunale për Integrim

Shtypi: Qendra e shtypit e qarkut Viersen

Data: nëntor 2022

Fotot: ©Qarku Viersen – përveç nëse shënohet ndryshe

Infografika: ©Qarku Viersen – Qendra Komunale për Integrim

